

VENDIM
Nr. 433, datë 10.6.2026

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË INSPEKTOR ENEA
SELADIN MEKOLLIT, ISH-PUNONJËS POLICIE, I CILI KA HUMBUR JETËN NË
KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, familjes së inspektor Enea Seladin Mekollit, ish-punonjës policie në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, i cili ka humbur jetën në krye të detyrës.
 2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu